



REPUBLIKA E SHqipëRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE  
TË SHKOLLAVE ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK  
(DEGËT: *ART FIGURATIV, KOREOGRAFI, MUZIKË*)**

**2020**

**1. HYRJE**

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve, “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të qëndrueshme përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të shkollave në drejtim të orientuar artistik, në degët: koreografi, art figurativ, muzikë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik degët: *koreografi, art figurativ dhe muzikë* në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar ku ndodhen këto tipe shkollash, për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-ja ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- ✚ dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësimdhënie - nxënies;
- ✚ programet përkatëse të specialiteteve sipas degëve;
- ✚ aspekte të pedagogjisë, metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi dhe të degëve përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi;
- ✚ aspekte të etikës dhe komunikimit;
- ✚ aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- ✚ përmbajtjen shkencore sipas specialiteteve dhe sipas degëve.

## 2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- ❖ të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, në degët përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi, në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- ❖ të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### ***Programi synon që mësuesi:***

- të njohë dhe zbatojë legjisllacionin arsimor, sidomos në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie cilësore dhe të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve ku ata japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;

---

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe, gjatë procesit të mësimdhënie -nxënies.
- të përdorë aftësitë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien bashkëkohore.

### 3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- ✓ kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e tyre;
- ✓ literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të degëve dhe profileve përkatëse.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

<b>FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”</b>	
<b>Kompetenca</b> “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi;</li> <li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Udhëzimi nr.18, datë 20.08.2019 “Për vitin shkollor 2019-2020 në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> </ul>

<p>rregulloret për personelin e shkollës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li> <li>- zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>- respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>- respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>- zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> </ul>
--	--

<b>FUSHA: KURRIKULA E TË TRI DEGËVE: KOREOGRAFI, ART FIGURATIV DHE MUZIKË</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi në mënyrë efektive i kurrikulës në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton risitë e kurrikulës në <i>degën</i> dhe <i>specialitetin</i> përkatës dhe si zbatohet ajo në shkollë;</li> <li>• përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>• zbaton strukturën e programeve të kurrikulës së shkollave artistike, për degën që i përket, në përgjithësi dhe përkatësisht të lëndës që jep (rubrikat);</li> <li>• shpjegon vendosjen e rezultateteve të nxënësit për lëndën/specialitetin;</li> <li>• përcakton hapat për zhvillimin e koncepteve apo aftësive kryesore që duhet të përftojë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare 2014.</li> <li>• Kurrikula e re e shkollave artistike, miratuar nga MASR-ja, Tiranë, 2017.</li> <li>• Qëllimet e arsimit me drejtim të orientuar artistik, (sipas degës).</li> <li>• Profili profesional artistik i nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik (sipas degës).</li> </ul> <p><i>I. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin e mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën art figurativ, muzikë dhe koreografi, sistemi 3- vjeçar.</i></p> <p><i>II. Kompetencat e përgjithshme profesionale artistike të nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm me</i></p>

<p>nxënësi në lëndën/specialitetin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon qartazi aftësitë dhe kompetencat te nxënësit lidhur me programin e lëndës/specialitetit;</li> <li>• përshkruan hapat e ndjekur për realizimin e arritjeve të nxënësit;</li> <li>• planifikon mjetet e nevojshme për realizimin e efikas të orës së mësimi, duke dhënë momentet kur i përdor ato;</li> <li>• vlerëson nxënësit sipas nivelit të arritjes dhe performancës, duke i përshkruar ato me terminologjinë e caktuar për këtë lloj shkollimi;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e <i>specialitetit</i> në degën përkatëse, me artet e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	<p><i>drejtim të orientuar artistik degën art figurativ, muzikë dhe koreografi sistemi 3-vjeçar.</i></p> <p><i>III. Kompetencat specifike profesionale artistike të nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, degën art figurativ, muzikë dhe koreografi sistemi 3-vjeçar.</i></p> <p><i>IV. Mundësitë e arsimit të mëtejshëm dhe të punësimit në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik në degën art figurativ, muzikë dhe koreografi sistemi 3-vjeçar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Plani mësimor, (sipas degës).</li> <li>• Udhëzime për planin mësimor, (sipas degës), sistemi 3 vjeçar.</li> <li>• Udhëzime për procesin mësimor, (sipas degës), sistemi 3 vjeçar.</li> <li>• Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.</li> <li>• Të dhëna për “Dëftesën e Pjekurisë” që përfitohet në përfundim të arsimit profesional artistik, (sipas degëve), sistemi 3-vjeçar.</li> <li>• Programet e përgjithshme të lëndëve: <i>teorike-artistike.</i></li> <li>• Programet e lëndëve: <i>teorike-praktike-artistike.</i></li> <li>• Programet e lëndës së <i>specialitetit.</i></li> </ul>
--	--

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË  
TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE**

<b>Kompetenca I</b> <b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>- përshtat punën e tij me zhvillimin <i>fizik, social, emocional</i> dhe <i>konjitiv</i> të nxënësve;</li> <li>- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet ndaj performancës së nxënësit;</li> <li>- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj <i>arteve</i> dhe <i>specialitetit</i> që përfaqëson/drejton;</li> <li>- edukon të nxënësit dëshirën ndaj artit që përfaqëson;</li> <li>- motivon nxënësit, duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>- punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit të shkollave me drejtim të orientuar artistik me nxënësit e tij.</li> </ul>
<b>Kompetenca II</b> <b>“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e <i>specialitetit/lëndës</i> në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zotëron një larmi metodash/strategjish të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> </ul>

<p>mësimdhënies efikase në degën ku ai zhvillon specialitetin/lëndën;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- planifikon mësimin, bazuar mbi një teknikë apo metodë mësimore specifike të specialitetit;</li> <li>- organizon mësimin bazuar në rezultate të pritshme;</li> <li>- harton një plan ditar sipas një skeme të caktuar, duke dhënë shpjegimet përkatëse;</li> <li>- planifikon mësimin, bazuar mbi një metodë mësimore;</li> <li>- shpjegon teknikat e vlerësimit për specialitetin e tij.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin, metodologjinë e mësimdhënies arteve, bazuar në specialitetin/lëndën përkatëse.</li> <li>- Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e: <ul style="list-style-type: none"> <li>- rezultateve të orës së mësimin,</li> <li>- përgatitjen e ditarit të mësuesit,</li> <li>- organizimin e orës së mësimin.</li> </ul> </li> </ul>
<p><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies, në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon materialet apo dokumentet e veta lidhur me lëndët teorike/praktike artistike, duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Finale, Design, Type në Word etj.;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të specialitetit/ lëndës në degën përkatëse apo në projekte kurrikulare të integruara degët e tjera artistike, të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literaturë që ka në fokus përdorimin e programeve kompjuterike me fokus artet (shkrimi i notave, design, photoshop etj).</li> </ul>

### FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura
<b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Draft-Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA, (sot ASCAP) 2016.</li> <li>• Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.</li> </ul>

### FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Kompetenca	Literatura
<b>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe:</b>	
<p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>• demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>



**FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

<p align="center"><b>Kompetenca</b></p> <p align="center"><b>“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien dega muzikë”</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik, dega muzikë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi njohuri të sakta dhe të qëndrueshme shkencërisht mbi muzikën dhe zhvillimin e saj.</li> <li>• shpjegon elementet dhe parimet e muzikës.</li> <li>• shpjegon ndërtimin e formave të ndryshme muzikore si klasifikimin e orkestrave.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Kompleksi i dhomës</i></li> <li>- <i>Banda;</i></li> <li>- <i>Orkestrat dhe llojet e tyre</i></li> <li>- <i>Format muzikore</i></li> <li>- <i>Periudha muzikore</i></li> <li>- <i>Minueti</i></li> <li>- <i>Rondoja</i></li> <li>- <i>Fuga</i></li> <li>- <i>Sonata</i></li> <li>- <i>Koncerti</i></li> <li>- <i>Simfonia</i></li> <li>- <i>Opera</i></li> <li>- <i>Etj.</i></li> <li>• shpjegon vlerat e muzikës botërore, duke përshkruar karakteristikat e secilës periudhë dhe përfaqësuesit e tyre.</li> <li>- <i>muzika në Mesjetë,</i></li> <li>- <i>muzika në Rilindje, përfaqësuesit dhe veprat e tyre,</i></li> <li>- <i>muzika në Klasicizëm, përfaqësuesit dhe</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti i historisë së muzikës për shkollat e mesme të muzikës – vëllimi i parë dhe i dytë, autorë Hamide Stringa ose Spiro Kalemi, botim i SHBLSH-së.</li> <li>• Tekstet e historisë së muzikës, Botime të SHBU-së</li> <li>• Manuali Artet – pjesa e muzikës – Prof. Dr. Fatmir Hysi, botim IKT (sot ASCAP), 2009.</li> </ul>

<p><i>veprat e tyre,</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>muzika Romantike dhe post Romantike,</i></li> <li>- <i>përfaqësuesit dhe veprat e tyre.</i></li> <li>• shpjegon vlerat e muzikës shqiptare, duke përshkruar karakteristikat e secilës periudhë dhe përfaqësuesit e tyre.</li> <li>- <i>opera e parë,</i></li> <li>- <i>baleti i parë,</i></li> <li>- <i>simfonia e parë,</i></li> <li>- <i>vepra të tjera të muzikës shqiptare.</i></li> <li>- <i>muzika e lehtë dhe moderne: rrymat përfaqësuesit dhe veprat e tyre.</i></li> <li>- <i>muzika kosovare, karakteristika, vepra dhe përfaqësues.</i></li> </ul>	
---	--

<b>FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në</b> <b>mësimdhënien dega art pamor</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik dega “Art pamor”:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi njohuri të qëndrueshme dhe të sakta shkencërisht në artin pamor.</li> <li>• shpjegon elementet dhe parimet, duke i evidentuar ato në vepra të ndryshme arti.</li> <li>• shpjegon proceset e realizimit artistik në artin pamor.</li> <li>• shpjegon saktë vlerat e artit botëror dhe përfaqësuesit e tyre.</li> <li>- <i>Arti prehistorik, arti në Mesopotami, arti egjiptian, arti egje, arti grek, arti romak, kristianizmi i hershëm, arti bizantin, përfaqësuesit dhe veprat e tyre.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti “Arti i Rilindjes dhe i Pavarësisë në Shqipëri”, me autor Ferid Hudhri.</li> <li>• Teksti “ Historia e artit” Gombrich, që përdoret në Akademinë e Arteve.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Arti islamik, arti kinez, qytetërimet e hershme në Amerikë.</i></li> <li>- <i>Arti në mesjetë, mesjeta e hershme, arti romanik, arti gotik.</i></li> <li>- <i>Arti në rilindje, gotiku i vonë, rilindja e pare, rilindja e lartë, manjerizmi, baroku, rokoko.</i></li> <li>- <i>Neoklasicizmi, romantizmi, realizmi, impresionizmi, postimpresionizmi, avangardat artistike, arti në shekullin XX.</i></li> <li>• Shpjegon saktë vlerat e artit shqiptar dhe përfaqësuesit e tyre. <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Arti shqiptar (kultura ilire), arti grek i kolonive (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu) mozaikët e lashtë në Shqipëri.</i></li> <li>- <i>Onufri, arti në Shqipëri- ikonografët e shekullit XVIII.</i></li> <li>- <i>Arti në Shqipëri- periudha e rilindjes dhe periudha e pavarësisë, realizmi socialist në Shqipëri.</i></li> </ul> </li> </ul>	
---	--

<b>FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien dega koreografi</b>	
<p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik, dega “Koreografi”:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi njohuri të qëndrueshme dhe të sakta shkencërisht në artin koreografik.</li> <li>• shpjegon elementet dhe parimet e artit koreografik, duke i evidentuar ato në vepra të ndryshme koreografike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Manuali për mësuesit e arteve, pjesa e kërcimit – botim i IKT-së, 2009.</li> <li>• Historia e Baletit Botëror, Skënder Selimi, maket 1992.</li> <li>• <u>Baleti në Shqipëri / Skënder Selimi dhe Spartak Kumbaro, 1992.</u></li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon proceset e realizimit artistik në një kërcim.</li> <li>• shpjegon saktë vlerat e artit të kërcimit botëror dhe përfaqësuesit e tyre.</li> </ul> <p><i>Baleti në Evropë gjatë shek. XVII – XVIII:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimi i mëtejshëm i kërcimit,</li> <li>- shkollat dhe koreografët italianë dhe francezë,</li> <li>- tiparet kryesore.</li> </ul> <p><i>Epoka e Noverit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Reformat e Zhan Zhak Noveri,</li> <li>- baletet kryesore të Nover.</li> </ul> <p><i>Romantizmi dhe tiparet e tij në kërcim:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Botëkuptimi romantik;</li> <li>- Baleti i parë romantik;</li> <li>- Koreografët, kërcimtarët dhe kompozitorët më të njohur të romantizmit.</li> </ul> <p><i>Baleti Rus në shek. 20 dhe baletet e para simfonike:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i baletit rus;</li> <li>- “Rilindja” e kërcimit klasik;</li> <li>- Marius Petipa dhe P.I.Çajkovski;</li> <li>- Anterpriza e S.Djagilievit.</li> </ul> <p><i>Kërcimi klasik në shek. 20 dhe format kryesore të tij:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërcimi Klasik në Evropë;</li> <li>- Kërcimi Klasik në Amerikë;</li> <li>- Format e baleteve;</li> <li>- Përfaqësuesit më të njohur.</li> </ul> <p><i>Lindja e kërcimit modern dhe përfaqësuesit e tij:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lindja e kërcimit modern në Amerikë</li> <li>- Zhvillimi i tij në Evropën</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Transkriptime të valleve të ndryshme: Vallja e Fajes, Napolonit, Librazhdit, Tropojës etj.</li> </ul>
---	--

<p>Perëndimore;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shkollat kryesore;</li><li>- Përfaqësuesit.</li></ul> <p><i>Baleti në Shqipëri:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Lindja e baletit në Shqipëri;</li><li>- Pedagogët dhe kërcimtarët e parë;</li><li>- Krijimi i shkollës dhe trupës profesionale;</li><li>- Baletet shqiptare.</li></ul>	
--	--